



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E POLICISË SË SHPETIT**

Nr. 259 prot., datë 12.02.2025

Nr. 238/12 prot., datë 13.02.2025

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR MARRJEN E MASAVE EFEKTIVE KUNDËR KRIMEVE ZGJEDHORE**

Në mbështetje të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, ligjit nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, i ndryshuar.

PALËT NË MARRËVESHJE:

Prokuroria e Përgjithshme (në vijim: PP, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm) të përfaqësuara nga **Prokurori i Përgjithshëm Z. Olsian ÇELA**, dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim: DPPSH) e përfaqësuar nga **Drejtori i Përgjithshëm Drejtues Madhor Ilir PRODA**, në vijim referuar si “Palët”,

DUKE MARRË NË KONSIDERATË:

- Nevojën për garantimin e një procesi të rregullt ligjor duke parandaluar e ndëshkuar çdo veprimtari të paligjshme që cënon votën e lirë;
- Detyrimet ligjore të Policisë dhe Prokurorisë, për zbatimin e Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e zgjedhjeve;
- Rëndësinë e një bashkëpunimi të ngushtë ndërinstytucional, për të rritur efektivitetin e masave kundër krimit zgjedhor.

Palët bien dakord për të nënshkruar këtë Marrëveshje Bashkëpunimi:

Neni 1
Objekti dhe parimet

1. Kjo Marrëveshje përcakton mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet palëve për të rritur efektivitetin në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, që prekin procesin zgjedhor sipas kompetencave që ligji parashikon, me qëllim garantimin për zhvillimin e një procesi të lirë dhe ligjor të zgjedhjeve, të ushtrimit të së drejtës kushtetuese të shtetasve për të votuar dhe zgjedhur si dhe zhvillimin e aktivitetit elektoral në përputhje me ligjin.
2. Parimet drejtuese të këtij bashkëpunimi, janë ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe aktet e tjera në fuqi në ushtrimin e veprimtarisë së prokurorisë dhe policisë gjyqësore.

Neni 2
Angazhimet e Prokurorisë së Përgjithshme

1. Prokuroria angazhohet për krijimin e seksioneve të posaçme për hetimin e krimeve zgjedhore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.
2. Kompetencat dhe veprimtaria e seksioneve do të ushtrohet deri në datën 31.05.2025, ndërsa çështjet në verifikim apo hetim do vijojnë të ndiqen nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore që u janë caktuar, deri në përfundimin e tyre.
3. Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, angazhohet të caktojë një prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme për bashkëpunim dhe koordinim në nivel qendror.
4. Prokuroria angazhohet të ndjekë dhe hetojë në mënyrë të menjëhershme gjithë veprat penale të raportuara që lidhen me zgjedhjet.
5. Prokuroria angazhohet që në kuadër të hetimeve:
 - a) të koordinojë veprimet me Policinë, duke dhënë udhëzime për procedurat hetimore dhe veprimet e mëtejshme që do kryejë ajo për çështjet e referuara pranë këtij organi;
 - b) të sigurojë mbështetje ligjore për Policinë, duke e autorizuar të kryejë veprime të posaçme, si kontrolle, sekuestre, vëzhgime, përgjime dhe ndalime/arrestime në rastet e nevojshme;
 - c) të ndërmarrë masa për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe denoncuesve të veprave penale zgjedhore;
 - d) të informojë publikun për rastet e ndjekura, duke ruajtur konfidencialitetin e hetimeve.

Neni 4
Angazhimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

1. DPPSH angazhohet të caktojë pranë çdo seksioni të posaçëm një numër të nevojshëm oficerësh të policisë gjyqësore nga shërbimet e Policisë së Shtetit, sipas kërkesës së drejtuesit të prokurorisë së shkallës së parë, si dhe dhe garantojë palëvizshmërinë e tyre.
2. DPPSH angazhohet të sigurojë palëvizshmërinë e oficerëve të caktuar sipas pikës 1 të këtij neni.

3. DPPSH angazhohet që përzgjedhja dhe caktimi i oficerëve të policisë gjyqësore të bazohet në kriteret si vijojnë:
 - a) të kenë eksperiencë në punë jo më pak se 4 vjet;
 - b) të kenë eksperiencë ose të kenë marrë pjesë në trajnime për hetimin e veprave penale që çënojnë procesin për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike;
 - c) të mos kenë lidhje të njohura apo të ngushta miqësore ose familjarë me politikanë, deputetë, kandidatë në zgjedhje apo financues të fushatave zgjedhore.
4. DPPSH angazhohet të vendosë në dispozicion të seksioneve të posaçëm, ekspertizë, pajisje logjistike dhe grupe operationale.
5. DPPSH angazhohet që në kuadër të parandalimit dhe hetimit të krimeve zgjedhore:
 - a) të forcojë masat e sigurisë pranë qendrave të votimit dhe institucioneve të përfshira në procesin zgjedhor, me qëllim garantim e integritetit të procesit zgjedhor;
 - b) të monitorojë dhe raportojë në kohë reale veprime të dyshimta që mund të përbëjnë vepra penale në fushën e zgjedhjeve;
 - c) të bashkëpunojë ngushtë me Prokurorinë për mbledhjen dhe administrimin e provave me qëllim dokumentimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, duke informuar në kohë atë;
 - ç) të reagojë shpejt ndaj informacioneve dhe denoncimeve që lidhen me krimet zgjedhore, duke kryer verifikimet paraprake e procedurale dhe referuar çështjet në Prokurori;
 - d) të ruajë paanshmërinë, të veprojë në përputhje me Kodin zgjedhorë dhe aktet e tjera nënligjore, pa ndikuar në procesin zgjedhor.

Neni 5

Trajnimet

Palët bashkëpunojnë dhe koordinojnë ndërmjet tyre për zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta, apo të veçanta për punonjësit e policisë që lidhen me hetimin e veprave penale që çënojnë procesin zgjedhor.

Neni 6

Personat e Kontaktit

1. Palët caktojnë dhe i komunikojnë njëra-tjetrës personat e kontaktit në nivel qendror, për komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.
2. Palët organizojnë takime të përbashkëta me kërkesë të secilës nga palët sipas dinamikës, në funksion të arritjes së rezultateve në luftën kundër krimit zgjedhor.

Neni 7

Konfidencialiteti dhe Transparenca

1. Palët marrin përsipër që informacionet e marra në zbatim të kësaj Marrëveshjeje të trajtohen në përputhje me standardet e ruajtjes së fshehtësisë të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore për sigurinë, sekretin hetimor dhe konfidencialitetin.
2. Informimi i publikut mbi masat kundër krimit zgjedhor të bëhet në përputhje me ligjin, duke shmangur çdo ndikim në procesin zgjedhor.

Neni 8

Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët.
2. Palët angazhohen të zbatojnë Marrëveshjen me mirëbesim dhe në përputhje me ligjin.
3. Palët mund të rishikojnë dhe ndryshojnë marrëveshjen në bazë të nevojave që mund të lindin gjatë zbatimit të saj.
4. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) njësi origjinale. Palët mbajnë secila nga 2 (dy) kopje.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Drejtues Madhor ILIR PRODA

